



## BRUKSEL, HASANI: NATO TË MOS LARGOJË VËMENDJEN NGA BALLKANI PERËNDIMOR

Në ditën e parë të takimit të Ministrave të Punëve të Jashtme të NATO-s, që po mbahet në selinë qendrore të Aleancës në Bruksel, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, nënvizoi domosdoshmërinë që NATO mos të largojë vëmendjen nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, pasi kjo kontribuon në paqen dhe stabilitetin e rajonit.



## MINISTRI HASANI TAKON HASHIM THAÇIN: KA MBËSHTETJEN TONË, E DREJTA DO TË TRIUMFOJË

Diplomacia shqiptare do të ngulë këmbë në zbatimin e standardeve për një proces gjyqësor të hapur e transparent në respektim të plotë të të drejtave të njeriut sipas konventave ndërkombëtare. Kështu u shpreh Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, pas vizitës që zhvilloi në Hagë me ish-Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi.



## HASANI: BESIMPLOTË NË BASHKËPUNIMIN ME QEVERINË E RE TË ARDHSHME KROATE, NË TË NJËJTËN FRYMË TË PARTNERITETIT STRATEGJIK

MEPJ Igli Hasani zhvilloi një vizitë zyrtare një ditore në Zagreb. Gjatë qëndrimit në Zagreb, Ministri Hasani u prit në takim nga Presidenti Zoran Milanović, Kryeministri Andrej Plenković dhe homologu i tij kroat, Gordan Grlić-Radman.



## SHQIPËRIA DHE MOLDAVIA TË PËRKUSHTUAR PËR TË PUNUAR SË BASHKU NË ZBATIMIN E REFORMAVE PËR NË BE

MEPJ Igli Hasani mirëpriti në Tiranë zv. kryeministren për Integrimin Evropian të Republikës së Moldavisë, Cristina Gherasimov. Dy zyrtarët diskutuan për marrëdhëniet e mira mes Shqipërisë dhe Moldavisë dhe mbi mënyrat praktike për intensifikimin e dialogut politik në rrugën e përbashkët të integrimit në BE.



## HAGË, MINISTRI HASANI: LLOGARIDHËNIA PËR UKRAINËN TË SHKOJË PARALELISHT ME ARRITJEN E PAQES

Në konferencën “Rivendosja e Drejtësisë në Ukrainë”, që u organizua në Hagë, Holandë, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani theksoi se Rusia duhet të mbajë përgjegjësi e të paguajë për vuajtjet e civilëve të pafajshëm dhe dëmet ekonomike në Ukrainë.



## SHQIPËRIA DEL NGA FAZA E MONITORIMIT TË KIE PAS 29 VITESH

Ministri Hasani falënderoi “Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe raportuesin Ionut Stroe, për njohjen e reformave transformuese të drejtësisë në Shqipëri, luftën tonë kundër korrupsionit dhe përparimin e Shqipërisë në të drejtat e njeriut dhe demokracinë.



## MINISTRI HASANI: VENDIMI NË FAVOR TË ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË KIE, HISTORIK

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, e cilësoi vendimin e Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës në favor të anëtarësimit të Kosovës në KiE, si një moment historik për Kosovën dhe popullin e saj.



## SË SHPEJTI, TRE PËRFAQËSI TË REJA DIPLOMATIKE NË KENIA, INDI E INDONEZI

Shqipëria do të ketë së afërmi përfaqësitë e saj diplomatike edhe në Kenia, Indi e Indonezi, duke forcuar kështu pasaportën shqiptare në botë. Lajmin e bëri të ditur Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, i cili theksoi se në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave, u miratua hapja e ambasadave në këto 3 shtete.



## MINISTRI HASANI: NJË NATO E FORTË, THELBËSORE PËR SIGURINË E BREZAVE TË ARDHSHËM

Nga selia qendrore e NATO-s në Bruksel, gjatë ceremonisë zyrtare për 75-vjetorin e Aleancës, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, tha se një lidhje e fortë euroatlantike, është thelbësore për paqen dhe sigurinë e ardhshme të brezave.



## TENSIONET NË LINDJEN E MESME, 28 QYTETARË SHQIPTARË KTHEHEN NË ATDHE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, bëri me dije se përmes koordinimit të pandërprerë me ambasadat e Republikës së Shqipërisë në Izrael e Egjipt, u organizua kthimi i të gjithë qytetarëve shqiptarë, fluturimet e të cilëve u anulua për shkak të situatës së tensionuar në Lindjen e Mesme.



## RIKTHEHET “ISHUJT”, MEPJ PRANË SHTETASVE SHQIPTARË NË ZONAT PËRRETH ISHUJVE TË EGJEUT/MESDHEUT

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme edhe këtë vit do të mundësojë realizimin e projektit “Ishujt 2024”, me qëllim pajisjen me dokumente biometrike të shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në zonat përreth ishujve të Egjeut/Mesdheut



## HASANI: BASHKËPUNIMI MULTILATERAL ME FINLANDËN, DËSHMI E ANGAZHIMIT TË PËRBASHKËT PËR TË ADRESUAR SFIDAT GLOBALE

MEPJ Igli Hasani priti në një takim një grup anëtarësh të Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit të Finlandës. Në takim u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira dypalëshe mes Shqipërisë dhe Finlandës, si dhe u diskutuan mënyra për të intensifikuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë.